

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

February 13 & 19 | Workshop on the German Supply Chain Law-KDWW/OEGJK

February 14 | Business After Hours & Publication of "Republic of Kosovo: Facts and Figures"-OEGJK/ KDWW and Konrad-Adenauer-Stiftung

February 20 | E-WORLD ENERGY & WATER in Essen

February 21 | Official Ceremony for the Establishment of KDWW-FinTech Cluster-OEGJK/ KDWW

February 22 | Power to HR by KosovaJob

February 22 | Online-Seminar 10. Western Balkans Purchasing Initiative

February 23&24 | Digital Accounting Conference-Melita dhe Partners

February 26 | N4CEB Workshop-OEGJK/KDWW

## Director's Note

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Kjo javë ishte përplot me aktivitete produktive dhe angazhime për OEGJK.

Gjatë kësaj jave u zhvillua takimi i parë i Clean Call Alliance për vitin 2024, ku diskutimet u përqendruan në planifikimin strategjik dhe integritetin ligjor brenda sektorit BPO.

Ankandi i parë i Ministrisë së Energjisë në energjinë e rinovueshme është mbyllur zyrtarisht - gjashtë ofertues, duke përfshirë anëtarin e KDWW-së, Notus Energy, kanë garuar për një projekt në energji diellore prej 100MW në Kosovë.

Bashkëpunimi ynë me Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS) sjell botimin e dytë të "Republic of Kosovo: Facts and Figures", që synon të nxjerrë në pah potencialin e investimeve në Kosovë për një audiencë globale.

Përveç kësaj, është hapur thirrja publike e Ministrisë së Ekonomisë për të mbështetur investimet në energji rinovueshme, e mbështetur nga BE-ja.

OEGJK vazhdon të përkrahë anëtarët përmes Shërbimit të Ekspertëve Senior, aktualisht tek kompania anëtare Creative Education po qendron eksperti gjerman për t'i përkrahur në internacionalizim.

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

This week has been filled with productive activities and engagements for KDWW.

Highlights include the first meeting of the Clean Call Alliance for 2024, where discussions centered on strategic planning and legal integrity within the BPO sector.

Exciting developments in renewable energy saw six bidders, including KDWW member Notus Energy, competing for a 100MW solar energy project in Kosovo, underscoring significant progress in this vital sector.

Our collaboration with the Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS) for the forthcoming publication of "Republic of Kosovo: Facts and Figures", that aims to spotlight Kosovo's investment potential to a global audience.

Additionally, the Ministry of Economy's public call to support renewable energy investment, backed by the EU, marks a pivotal moment for sustainable development, with active involvement from KDWW representatives.

Lastly, our dedication to professional growth is evident through the assignment of a German expert via KDWW's Senior Expert Service at Creative Education, reinforcing our commitment to international collaboration and knowledge exchange.

### Clean Call Alliance mbajti takimin e parë për 2024

Anëtarët e Clean Call Alliance (CCA) kanë mbajtur takimin e parë për vitin 2024. Në këtë takim u planifikuan aktivitetet e vitit 2024 dhe u diskutuan tema rreth sektorit të BPO-së.

Disa nga pikat kryesore të takimit të djeshëm përveç planifikimit të aktiviteteve të CCA-së, ishin edhe çështjet ligjore mbi punësimin dhe mundësia e diversifikimit të sektorit të BPO-së nga qendrat e thirrjeve të cilat ushtrojnë aktivitete të paligjshme.

Në takim përveç anëtarëve dhe drejtoreshën znj. Nora Hasani, mori pjesë edhe zëvendës-ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, z. Matthias Conrad.

CCA është më shumë se një rrjet i qendrave të thirrjeve në Kosovë. Qëllimi është të promovojë ndikimin pozitiv të sektorit të BPO, përfshirë këtu shërbimet ndaj klientëve, edhe ndërkombëtarisht. OEGJK në bashkëpunim me CCA-në, janë duke punur në mënyrë aktive për zhvillim ekonomik dhe promovim të sektorit në Kosovë.

### The Clean Call Alliance held its first meeting for 2024

Members of the Clean Call Alliance (CCA) gathered for the first meeting of 2024. During this meeting, the activities for 2024 were planned, and topics related to the BPO sector were discussed.

Some of the key points of yesterday's meeting, besides planning CCA activities, included legal issues regarding employment and the possibility of diversifying the BPO sector from call centers engaging in illegal activities.

In addition to the members and the director, Ms. Nora Hasani, the Deputy Ambassador of Germany to Kosovo, Mr. Matthias Conrad, also attended the meeting.

The Clean Call Alliance (CCA) is more than just a network of call centers in Kosovo. This network aims to promote the positive impact of the BPO sector, including customer service, both domestically and internationally. KDWV, in collaboration with the CCA, is actively working towards economic development and promotion of the sector in Kosovo.



## **Gjashtë oferta për ankandin e energjisë diellore organizuar nga Ministria e Ekonomisë në Kosovë**

Në ankandin e energjisë diellore 100MW të Ministrisë së Ekonomisë në Kosovë, 6 investitorë të huaj kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar ofertat e tyre.

Kompania gjermane Notus Energy, njëherit kompani anëtare e OEGJK-së, Akou Energy si dhe kompania Elswedy Electric, kanë aplikuar si kompani të pavaruara, kurse në konsorciume kanë aplikuar kompanitë Çalik dhe Limak, si dhe Güriş İnşaat ve Mühendislik – dhe një i udhëhequr nga grupi zviceran i ndërtimit Orllati. Këto kompani janë duke garuar për një projekt të energjisë diellore fotovoltaike prej 100 MW në Kramovik të Rahovecit.

Autoritetet po ofrojnë "Contract for difference (CfD)" 15-vjeçare dhe kontratë qiraje 30-vjeçare. Ministria e Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli njoftoi se Qeveria planifikon të hap ankande për 950 MW më shumë kapacitete të energjisë së ripërtitshme. Investimet e mundshme ajo vlerësoi se do të jenë 1.2 miliardë euro.

Ministrja gjithashtu njoftoi se, këtë vit planifikohet të lëshohet edhe thirrja publike për energjinë e erës 150 MW.

## **Six bidders for solar energy auction organized by the Ministry of Economy in Kosovo**

In the 100MW solar energy auction organized by the Ministry of Economy in Kosovo, six foreign investors have applied and submitted their offers.

The German company Notus Energy – member of KDWV, Akou Energy, as well as the company Elswedy Electric, have applied as independent companies, while the consortia applications include the companies Çalik and Limak, as well as Güriş İnşaat ve Mühendislik – and one led by the Swiss construction group Orllati. These companies are competing for a photovoltaic solar energy project of 100 MW in village Kramovik, near city of Rahovec.

The authorities are offering a 15-year contract for difference (CfD)" and a 30-year lease.

The Minister of Economy, Ms. Artane Rizvanolli, announced that the Government plans 950 MW more in renewable energy capacity. Minister Rizvanolli estimated the potential investments to be 1.2 billion euros.

The Minister also stated that this year, a public call is planned to be issued for 150 MW of wind power.

## **OEGJK dhe KAS do të publikojnë "Republic of Kosovo: Facts and Figures"**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare në bashkëpunim me Fondacionin Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS), do të publikojnë "Republic of Kosovo: Facts and Figures".

Ekspertët e mirënjohur të fushave përkatëse janë angazhuar në këtë Publikim i cili synon promovimin e Kosovës si vend me potencial për investime të huaja.

Publikimi do të bëhet më 14 shkurt nga ora 17:00 në Hotel Sirius, Salla Orion, 1<sup>st</sup> floor.

## **KDWV and KAS will publish "Republic of Kosovo: Facts and Figures"**

German-Kosovar Business Association in cooperation with Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS) are going to publish "Republic of Kosovo: Facts and Figures".

With the contribution of many experts in their respective fields, this publication aims to promote Kosovo as a country with potential for foreign investments.

The publication will be released on February 14th at 17:00 at Hotel Sirius, Orion Hall, 1<sup>st</sup> floor.

## **Kosova hapi thirrje publike për mbështetje të prosumerëve familjar dhe biznesor**

Ministria e Ekonomisë ka lansuar thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme, të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ngjarje në të cilën mori pjesë edhe përfaqësuesja e OEGJK-së, znj. Eriola Muhaxhiri.

Me anë të kësaj thirrje qytetarët do të mbështeten në dy forma. E para për Investimin në Sisteme të Energjisë së Ripërtëritshme - sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum dhe forma e dytë për sisteme diellore për ngrohjen e ujit sanitar.

Familjet mund të aplikojnë për mbështetje për sisteme diellore me kapacitet prej 3kW deri në 7 kW, ku do të subvencionohen me 250 EUR për kW, deri në 1,750 EUR në total të investimit.

Për ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme vlera e subvencionimit do të jetë 250 EUR në kW me kapacitet prej 3 kW deri në 9 kW, maksimalisht deri në 2,000 EUR në total të investimit. Për kapacitet prej 10 kW e më lartë, bizneset do të subvencionohen me 200 EUR për kW deri në 600 EUR në total të investimit.

Për instalimin e sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar, që nga mesi i muajit shkurt 2023, bizneset do të mund të subvencionohen 40% të vlerës investive deri në 4,000 EUR në total.

Në rastet kur bizneset do të jenë në pronësi të grave, apo në bashkëpronësi mbi 51%, atëherë Qeveria do t'i shtojë edhe 200 EUR në subvencionim. Në të njëjtin event, kompanitë që merren me instalime solare, kanë ekspozuar punën dhe kapacitetet e tyre, në mesin e të cilave ishin edhe kompanitë anëtare të OEGJK-së: Elen Solar, Jaha Solar dhe Unisolar.

## **Kosovo launches public call for support of household and business prosumers**

The Ministry of Economy has issued a public call to support household consumers and micro, small, and medium-sized enterprises for investment in renewable energy systems, supported by the European Union Office in Kosovo. The event was attended by KDWV representative, Ms. Eriola Muhaxhiri.

Through this call, citizens will be supported in two different forms. The first is for Investment in Renewable Energy Systems - photovoltaic (PV) systems for electricity production for self-consumption and second form is for Investment in Renewable Energy Systems - solar systems for water heating.

Families can apply for support for solar systems with capacities ranging from 3kW to 7 kW, where they will be subsidized with €250 per kW, up to €1,750 in total investment.

For micro, small, and medium-sized enterprises, the subsidy will be €250 per kW for capacities ranging from 3 kW to 9 kW, up to a maximum of €2,000 in total investment. For capacities of 10 kW and above, businesses will be subsidized with €200 per kW, up to €600 in total investment.

For the installation of solar water heating systems, starting from mid-February 2023, businesses may be subsidized for 40% of the investment value, up to €4,000 in total.

In cases where businesses are owned by women or are jointly owned by women holding at least 51% ownership, the Government will add an additional €200 to the subsidy.

At the same event, companies engaged in solar installations showcased their work and capacities, among which were also member companies of the KDWV: Elen Solar, Jaha Solar, and Unisolar.



**Drejtoresha e OEGJK, znj. Nora Hasani mori pjesë në Konferencën Regjionale “Formësimi i agjendës për zvogëlimin e barrës administrative në Ballkanin Perëndimor”**

Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, znj. Nora Hasani mori pjesë në panelin mbyllës të konferencës “Formësimi i agjendës për zvogëlimin e barrës administrative në Ballkanin Perëndimor”.

Znj. Hasani gjatë diskutimit të saj në panelin “Mundësitë në uljen e barrës nga mbledhja e të ardhurave”, potencoi partneritetit e sektorit privat dhe domosdoshmërinë e përfshirjes së këtij sektori në politikbërje, kur ka të bëjë me reduktimin e barrës administrative.

Ndër të tjera në këtë konferencë u tha se duke thjeshtuar dhe dixhitalizuar shërbimet publike, reduktohen pengesat administrative dhe promovohen ndryshime pozitive ekonomike.

**Director of KDWV, Ms. Nora Hasani participated in the Regional Conference “Shaping The Future Agenda Of Administrative Burden Reduction In Western Balkans”**

As the director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Hasani took part in the closing panel discussion of the conference.

During her discussion on the panel "Opportunities in reducing burden through revenue collection," she emphasized the partnership of the private sector and the necessity of involving this sector in policymaking when it comes to reducing administrative burden.

Among other things, the conference highlighted that by simplifying and through digitalization of public services, administrative barriers are reduced, and positive economic changes are promoted.



### **Creative Education angazhon ekspertë gjerman përmes OEGJK-së nga SES**

Mundësinë për të angazhuar ekspert gjerman me një kosto të përballeshme, përmes Senior Expert Service që e ofron OEGJK, e ka shfrytëzuar kompania anëtare Premium, Creative Education.

Si shkollë e gjuhëve të huaja, Creative Education ka angazhuar ekspertin znj. Marthe Blümel që do të merret me aftësimin e mëtutjem të ligjëruesve, që të përputhen me metodologjinë moderne dhe didaktikën e mësimeve. Gjithashtu, znj. Blümel ka këshilluar stafin edhe për materialet që duhet të përdoren.

Ekipin e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, të përbërë nga përfaqësuesja e këtij shërbimi, znj. Elena Elshani dhe Udhëheqësja e Departamentit për Hyrje në Treg dhe Evente, znj. Besarta Hyseni, i kanë pritur z. Arian Haradinaj dhe znj. Miranda Molliqaj nga Creative Education, duke i informuar edhe për planet e zhvillimit në vitin 2024.

**Në Kosovë për momentin janë të angazhuar tre ekspertë gjermanë në kompani të ndryshme dhe të gjithë kanë ardhur përmes OEGJK-së.**

### **Creative Education has assigned an SES expert through KDWV**

Premium member company, Creative Education, has assigned a German expert at an affordable cost, through the Senior Expert Service offered by KDWV.

As a foreign language school, Creative Education has assigned expert Ms. Marthe Blümel to further train lecturers to align with modern methodology and didactics.

Additionally, Ms. Blümel has advised the staff on the materials to be used.

The team from the German-Kosovar Business Association, composed of the representative of SES within KDWV, Ms. Elena Elshani and the Head of Market Entry & Events, Ms. Besarta Hyseni were welcomed by Mr. Arian Haradinaj and Ms. Miranda Molliqaj from Creative Education, also informing them about development plans for 2024.

**Currently, three German experts are engaged in various companies in Kosovo, all of whom have been assigned through KDWV.**



### **ATK organizon Seminar për Tatimpagues**

Administrata Tatimore e Kosovës ka organizuar seminar për tatimpagues rreth ndryshimet ligjore sipas Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore.

Në këto seminare ftohen të marrin pjesë tatimpaguesit (organizata biznesi, OJQ apo përfaqësues të tyre), përfaqësues të njëjësive të përhershme, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar me qëllim që të informohen për të gjitha ndryshimet ligjore.

- Më 12 shkurt seminari mbahet në **Prizren** nga ora 10:30 në Hotel Theranda.
- Më 13 shkurt seminari mbahet në **Gjakovë** nga ora 10:30 në Shkollën e Muzikës "Prenk Jakova".
- Më 14 shkurt seminari mbahet në **Mitrovicë** nga ora 10:00 në sallën e AZHR-së në Zonën Industriale
- Më 15 shkurt seminari mbahet në **Ferizaj** nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal të qytetit.
- Më 16 shkurt seminari mbahet në **Gjilan** nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal të qytetit.

### **TAK is organizing a Seminar for Taxpayers**

The Tax Administration of Kosovo has organized a seminar for taxpayers regarding legal changes according to Law No. 08/L-257 on the Administration of Tax Procedures.

These seminars invite taxpayers (business organizations, NGOs, or their representatives), representatives of permanent units, accountants, and interested citizens in order to be informed about all legal changes.

- On February 12th, the seminar will be held in **Prizren** starting at 10:30 am at Hotel Theranda.
- On February 13th, the seminar will be held in **Gjakova** starting at 10:30 am at the "Prenk Jakova" School of Music.
- On February 14th, the seminar will be held in **Mitrovica** starting at 10:00 am at the AZHR hall in the Industrial Zone.
- On February 15th, the seminar will be held in **Ferizaj** starting at 10:00 am at the Municipal Assembly Hall of the city.
- On February 16th, the seminar will be held in **Gjilan** starting at 10:00 am at the Municipal Assembly Hall of the city.

**YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV**

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday – Friday | 8.30 – 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive

Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant

Senior Expert Service Representative (SES)

[elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org)



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve

Këshilltare për Arsimit Profesional Dual

Head of Market Entry & Events

Advisor for VET

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)



**Eriola Muhaxhiri**

Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie Qeveritare

Head of Department for Advocacy and Government Relations

[eriola.muhaxhiri@oegjk.org](mailto:eriola.muhaxhiri@oegjk.org)

**Jeta Syla**

Asistente Projekti

Project Assistant

Department for Market Entry & Events

[jeta.syla@oegjk.org](mailto:jeta.syla@oegjk.org)

**Rreze Gashi**

Koordinatorë

Coordinator

Department for Advocacy and Government Relations

[rreze.gashi@oegjk.org](mailto:rreze.gashi@oegjk.org)